

L I G J
Nr. 8030, datë 15.11.1995

PËR KONTRIBUTIN E SHTETIT PËR FAMILJET E PASTREHA
(Ndryshuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 5, datë 27.2.1997; me ligjin nr. 8647, datë 24.7.2000)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë detyrimet financiare të shtetit për të pastrehët që rezultojnë nga zbatimi i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe akteve nënligjore të tij, si dhe mënyrën e dhënies së kredisë për ta, duke lehtësuar zgjidhjen e strehimit të tyre dhe duke krijuar mundësi për të përfituar edhe nga tregu i lirë i tokës dhe banesave.

Neni 2

(Ndryshuar paragrafi i tretë me ligjin nr. 8647, datë 24.7.2000)

Çdo familje e pastrehë përfiton falas të drejtën për të shpenzuar një shumë parash sipas përcaktimeve të këtij ligji. Ky përfitim do të quhet shumë përfitimi.

Shuma e përfitimit falas të çdo familjeje të pastrehë do të përcaktohet nga numri i pjesëtarëve të familjes dhe mosha e tyre, si dhe kategoria e familjeve të pastreha, e përcaktuar nga akte nënligjore, sipas tabelës nr.1 që i bashkëngjitet këtij ligji.

Familjet e pastreha që banojnë në banesa shtetërore ish-pronë private, trajtohen nga shteti si kategori emergjente. Shteti u siguron atyre banesë nëpërmjet Entit Kombëtar të Banësive, me sipërfaqe banimi aq sa u takon sipas normave të strehimit dhe përbërjes familjare para datës 1.12.1992, por jo më tepër sesa disponon. Privatizimi i këtyre banesave kryhet sipas kritereve të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore” dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, duke i shtuar tarifës indeksin e korrigjimit të çmimeve.

Qiramarrësit në banesa ish-pronë private, që kërkojnë të sigurojnë banesë nëpërmjet tregut të lirë, përfitojnë falas nga shteti diferencën e vlerës sipas kostos aktuale të ndërtimit të Entit Kombëtar të Banësive, me tarifën e indeksuar.

Neni 2/1

(Shtuar me ligjin nr. 8647, datë 24.7.2000)

Familjet e konsideruara të pastreha, që në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë në përbërje të tyre invalidë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, ish-partizanë, luftëtarë antifashistë që kanë marrë pjesë në formacionet antifashiste para datës 29 nëntor 1944, përfitojnë strehim falas nga shteti sipas kritereve të ligjit nr. 8030, datë 15.11.1995.

Neni 3

Në qendrat e banuara ku vlera e apartamenteve tip në tregun e lirë është më e vogël se kostoja e ndërtimit nga Enti Kombëtar i Banesave, masa e përfitimit falas të familjeve të pastreha sipas nenit 2 shumëzohet me koeficientin k që del nga raporti i mëposhtëm, sipas udhëzimeve të Këshillit të Ministrave.

Vlera e ap.tip në tregun e lirë

$K = \frac{\text{Vlera e ap.tip në tregun e lirë}}{\text{Kostoja e ndërtimit nga Enti Kombëtar i Banesave}}$

Kostoja e ndërtimit nga Enti Kombëtar i Banesave

Në rastin kur qytetarët sistemohen në banesat në proces të trashëguara nga viti 1992, masa e përfitimit të tyre sipas tabelës nr.1 do të shumëzohet me koeficientin:

Detyrimi i qytetarit me Entin Kombëtar të Banesave

$kl = \frac{\text{Detyrimi i qytetarit me Entin Kombëtar të Banesave}}{\text{Kostoja e ndërtimit nga Enti Kombëtar i Banesave}}$

Kostoja e ndërtimit nga Enti Kombëtar i Banesave

Ky koeficient do të përdoret edhe për qytetarët që sistemohen në apartamente të ndërtuara para vitit 1993, për të cilat zbritet vlera e amortizimit.

Neni 4

Në qendrat e banuara ku vlera e apartamenteve tip në tregun e lirë është më e vogël se kostoja e ndërtimit nga Enti Kombëtar i Banesave, familjeve të pastreha apartamentet e reja do t'u shiten me vlerën e tregut të lirë, pavarësisht nga kostoja e ndërtimit të tyre.

Neni 5

Qendër e banimit për familjet e pastreha për llogaritjen e përfitimit do të merret qendra ku ata kanë përfituar statusin si të pastrehë, sipas dispozitave ligjore, pavarësisht nga lëvizjet e mëvonshme të tyre.

Për ushtarakët dhe nëpunësit shtetërorë të transferuar, për llogaritjen e përfitimit, qendër e banuar do të merret ajo ku ata kanë përfitimin më të madh.

Neni 6

Shumën e përfituar familjet e pastreha mund ta përdorin:

1. Për blerjen e banesave nga shteti ose privatët.
2. Për blerjen e truallit për ndërtim banese nga shteti ose privatët.
3. Për pagesën e qirasë së banesës shtetërore ose private.

Me përdorimin e shumës së përfituar, familjes i hiqet statusi i të pastrehut.

Neni 7

(Ndryshuar me ligjin nr. 8647, datë 24.7.2000)

Të gjitha veprimet financiare për dhënien e kredive dhe të subvencioneve shtetërore do të kryhen nga Banka e Kursimeve. Për banesat e ndërtuara ose të blera në tregun e lirë nga Enti Kombëtar i Banesave, subvencionet shtetërore për familjet e pastreha do të trajtohen nga vetë Enti Kombëtar i Banesave.

Neni 8

Banka e Kursimeve do të japë kredi për qytetarët e pastrehë për ndërtim ose blerje banese, sipas radhës në listat e përcaktuara nga organet e pushtetit lokal dhe sipas kriterëve të caktuara me vendime të Këshillit të Ministrave.

Vëllimi dhe termat e kredisë për këtë destinacion përcaktohen në fillim të çdo viti në marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Financave, Bankës së Shqipërisë dhe Bankës së Kursimeve.

Neni 9

Qiraja vjetore e banesave shtetërore do të jetë në vlerë sa 3 për qind e kostos së ndërtimit nga Enti Kombëtar i Banesave.

Qiraja do të llogaritet çdo vit dhe do të miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Për banesat e ndërtuara para vitit 1992 qiraja vjetore do të jetë sa 2.8 për qind e kostos aktuale të konvertuar.

Neni 10

(Ndryshuar me ligjin nr. 8647, datë 24.7.2000)

Deri në zgjidhjen e strehimit, qytetarët e pastrehë që banojnë në banesa ish-pronë private, do të paguajnë qira sipas tarifave që paguanin në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7698, datë 15.4.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.

Neni 11

(Shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 5, datë 27.2.1997)

Neni 12

Nuk përfitojnë nga ky ligj familjet e pastreha, në të cilat qoftë edhe një anëtar i tyre:

1. Ka përfituar nga ligji nr. 7501 “Për tokën”.
2. Ka blerë truall nga shteti për ndërtim banese para datës 1 janar 1996.
3. Ushtron veprimtari ekonomike dhe është subjekt i taksës së vlerës së shtuar, ose ka kapital (para në qarkullim, tokë, mall, ndërtime etj.) me vlerë më të madhe se dy herë sa vlera e banesës që do t’i takonte familjes së tij nga Enti Kombëtar i Banesave.
4. Ka në pronësi banesë jo më të vogël se normat e strehimit të familjes së tij të pastrehë.
5. I është ofruar shtëpi nga pushteti lokal ose pronari, por nuk ka pranuar ta marrë, megjithëse ka qenë brenda sipërfaqeve të normuara të strehimit e vazhdon të qendrojë në shtëpi pronë private.

Neni 13

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 14

Të gjitha dispozitat ligjore dhe nënligjore që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 1996.

Shpallur me dekretin nr. 1292, datë 20.11.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha

TABELA NR.1
SHUMA E PËRFITIMIT FALAS PËR ÇDO FAMILJE

në 000/lekë										
Nr.i pjesëtarë										
ve të familjes		SHUMA E VITEVE PËR GJITHË PJESËTARËT E FAMILJES								
		Deri 20		20-40	40-60	60-100	100-150	150-200		mbi
200	koef.1	2	3	4	5	6	7			
		1	130	230	330	430	-	-	-	k1 = 25
		2	150	250	350	450	550	600	-	k2 = 10
		3	180	280	380	480	580	630	680	k3 = 6
		4	210	310	410	510	610	660	710	k4 = 6
		5	240	340	440	540	640	690	740	k5 = 6
		6	270	370	470	570	670	720	770	k6 = 6
		>6								
		300	400	500	600	700	750	800	k7 = 6	

Llogaritjet në tabelën e mësipërme do të bëhen mbi shumën faktike të viteve për çdo familje p.sh.

1 familje me 4 frymë me 83 vite. Do të shohim në kolonën nr. 4.

$$510 - 410$$

$$\text{Për një vit vlera e përfitimit do të jetë } \frac{510 - 410}{100 - 60} = 2.5 \text{ (000/lekë)}$$

Masa e përfitimit të familjes do të jetë: $410 + (2.5 \times 23) = 467.5 \text{ (000/lekë)}$

Kur shuma e viteve është më e madhe se vlerat e dhëna në tabelë për çdo vit shtesë do të përdoret koeficienti përkatës.